

E nderuar zj. St. Laurent

Duke ju falënderuar perzemersisht qe pranuat te vinit ne Shqiperi per te marre pjese ne Seminarin “SAI dhe Parlamenti”, te organizuar ne kuadër te projektit IPA 2013 nga institucioni i auditimit suprem te Polonise(NIK) dhe nga SAI i Kroacise, te dy partnere te KLSH-se ne kete projekt per ngritjen e kapaciteteve tona audituese, si edhe për kumtesen me vlera qe paraqitët gjatë paradites së sotme, me lejoni qe ne emer te audituesve shqiptare, te them disa fjale fillimisht per historikun, filozofine e punes dhe zhvillimin e nje prej institucioneve supreme te auditimit me te fuqishem dhe me profesionalë ne komunitetin INTOSAI, Zyren e Auditimit te Qeverise se SHBA (GAO).

1. Si u krijua GAO?

Në fillesat e saj, Zyra e Përgjithshme e Kontabilitetit e Shteteve të Bashkuara(keshtu quhej fillimisht) ishte një organ mbikqyrës i aktiviteteve financiare të qeverisë. Pra ishte një organ që i përkiste pushtetit legjislativ dhe vepronte në shërbim të Kongresit dhe qytetarëve, duke mbikëqyrur çdo program financiar, si edhe çdo aktivitet dhe funksion të qeverisë federale. Stafit të këtij institucioni i ishte besuar kontrolli financiar i çdo aspekti të qeverisjes. Falë punës së këtij insitucioni tashmë aprovohen ligje, përmirësohet aktiviteti i qeverisjes,

si dhe sjell perfitime financiare ne miliarda dollarë në favor të taksapaguesve amerikanë.

Zyra e Përgjithshme e Kontabilitetit u krijua me Ligjin e Buxhetimit dhe te Kontabilitetit me 1 korrik te vitit 1921. Ligji kishte për qëllim përmirësimin e menaxhimit financiar federal, pasi shpenzimet e Luftës së Parë Botërore kishin rritur borxhin kombëtar. Për këtë arsye, ligjvënësve amerikane u nevojitej informacion i qartë dhe i saktë mbi shpenzimet e qeverisë dhe kontrollin mbi to.

Kongresi miratoi Ligjin e Buxhetimit dhe Kontabilitetit, i cili i kërkonte pushtetit ekzekutiv përgatitjen e buxhetit vjetor të qeverisë federale me qëllim përmirësimin e llogaridhënies. Ky ligj transferoi funksionet e auditimit dhe te kontabilitetit nga Departamenti i Thesarit tek GAO. Falë këtij ligji GAO u vendos si një organ i pavarur nga ekzekutivi, me një mandat të gjerë për të kontrolluar se si shpenzoheshin fondet federale. Me kalimin e viteve, legjislacioni i aprovuar nga Kongresi ka sqaruar dhe/ose zgjeruar kompetencat e GAO's, por Ligji i Buxhetimit dhe Kontabilitetit vazhdon ende të shërbejë si bazë për aktivitetet e këtij institucioni.

2. Vështrim i shkurter historik per GAO-n

Gjatë viteve 1920-te deri më 1930-te, GAO u orientua drejt një qasjeje kontrolluese. Kryesisht institucioni u fokusua në përcaktimin nëse shpenzimet qeveritare ishin kryer në përputhje me legjislacionin dhe

rregullat financiare në fuqi. Pjesa më e madhe e punës së agjencisë përqëndrohej në shqyrtimin e faturave financiare (nga ku shpjegohet edhe emërtimi i institucionit si Zyra e Përgjithshme e Kontabilitetit). Këto fatura ishin formati i përdorur nga zyrtarët e ekzekutivit, administratës qeveritare dhe zyrtarët e ndryshëm për të regjistruar informacionet mbi shpenzimet. Në atë kohë, disbursimet qeveritare kryheshin përmes pagesave me letra me vlerë. Mbasi këto pagesa ekzekutoheshin, të gjitha praktikat dërgoheshin pranë GAOs për t'u kontrolluar. Kjo periudhë e hershme e historisë së GAOs shpesh quhet epoka e kontrollit të faturave financiare.

Pas Luftës së Dytë Botërore, vëmendja e institucionit u zhvendos nga kontrolli i faturave për të kaluar në kontrolle më të plota të shpenzimeve federale. Ky ndryshim drejt shqyrtimit të ekonomicitetit dhe efektivitetit të operacioneve qeveritare në epokën e pasluftës shënoi ndryshimin e parë të madh evolucionar për GAO.

Në fund të viteve 1950-te dhe 1960-te, GAO u fokusua në punësimin e kontabilistëve, në zgjerimin e profesionalizimit të stafit dhe zgjerimin e hapësirave të zyrave. Periudha 1960 - 1970 solli një tjetër ndryshim të madh, pasi GAO zgjeroi punën audituese duke kaluar në vlerësimin e programeve federale.

Gjatë viteve 1980 dhe fillim të viteve 1990-te, GAO u përqëndrua në shqyrtimin e fushave me risk të lartë në aktivitetet qeveritare, duke i

kushtuar vëmendje të vecantë çështjeve buxhetore dhe përmirësimit të menaxhimit financiar federal.

Sot GAO shërben kombin duke kryer auditime performace dhe financiare të programeve qeveritare.

3. GAO permes drejtuesve te saj

a. Kontrollori i Parë i Përgjithshëm i GAO-s ishte Avokati **John R. McCarl** në raportin e tij vjetor për vitin 1926 shprehej se *"funksioni kryesor i Zyrës së Përgjithshme të Kontabilitetit është çështja nëse çdo shpenzim është kryer në përputhje me ligjin"*.

Ngarkesa e punës audituese së GAOs u rrit edhe më tepër gjatë vitit 1930, pasi paratë federale u përdorën për të financuar politiken e "New Deal" të Presidentit Rusvelt, përpjekjet e rimëkëmbjes dhe të ndihmës për të luftuar Depresionin e Madh. GAO filloi punën audituese në vitin 1921 me rreth 1700 të punësuar. Shumë shpejt e gjeti veten në mungesë personeli dhe nisi rekrutimet në procesin e shqyrtimit të faturave dhe dokumenteve mbështetëse. Në vitin 1939 GAO kishte rreth 5,000 të punësuar. Edhe pse Uashingtoni vazhdonte të ishte qendra e aktiviteteve të GAOs, audituesit për herë të parë filluan të kryenin punë audituese në terren gjatë këtyre viteve. Gjatë administratës Rusvelt, ata filluan auditimet e disa programeve bujqësore qeveritare në disa shtete jugore.

Si një mbikqyrës këmbëngulës financiar, McCarl la gjurmë të thella në pavarësinë dhe integritetin e këtij institucioni. "*Midis njerëzve të rëndësishëm të Uashingtonit, ai ishte i hapur, i vetmuar dhe inkurajues*", komentonte gazeta e kohës, St. Louis Post-Dispatch.

Kur u largua nga detyra, McCarl i dërgoi një letër stafit të GAOs, në të cilën u kërkoi audituesve të vazhdonin luftën për promovimin e "ndershmërisë në qeverisje."

b. Ne vitin 1940, **Lindsay C. Warren** një deputet i Dhomës së Përfaqësuesve u emërua Kontrollor i Përgjithshëm.

Një artikull në Arkivin e Kongresit, i datës 9 maj 1946 përshkruan qasjen e tij të re për menaxhimin e GAOs: "*Warren hapi dritaret, i pastroi ato nga pluhuri, krijoi stimuj. Ai solli në dritë mendje brilante që fshiheshin nëpër korridoret e institucionit dhe i vendosi ato në punë duke ndezur imagjnatën e tyre.*"

Në fund të viteve 1940-te, GAO filloi auditimin e ndërmarrjeve qeveritare, auditime keto te quajtura "gjithëpërfshirëse", si dhe u angazhua me insitucionet qeveritare për t'i ndihmuar ato në përmirësimin e sistemeve të tyre të kontabilitetit. Puna e Departamentit te Auditimit te Korporatave Publike dhe atyre te perziera publik-privat i parapriu ndryshimit rrënjësor të auditimeve të GAOs në fillim të viteve 1950, të cilat tashmë ishin vetëm auditime gjithëpërfshirëse, ose

auditime të përputhshmërisë, ligjshmërisë dhe efijences së përdorimit të fondeve publike.

Duke e larguar theksin nga transaksionet fiskale individuale, GAO filloi shqyrtimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm në agjencitë qeveritare. Institucioni u përqendrua në hartimin e parimeve të kontabilitetit, kryerjen e auditimeve, si dhe auditimin e kontrolleve dhe procedurave financiare. Me zhvendosjen në auditimin gjithëpërfshirës, GAO hartoi udhëzime të hollësishme. Fillimisht, në vitin 1952, hartoi një Manual të Auditimit Gjithëpërfshirës. Manuali përbëhej nga kapituj ku trajtoheshin tema mbi autoritetin dhe përgjegjësitë e auditimit; objektivat dhe politikat e auditimit; si kryhet auditimi; standardet e zbatueshme; natyra e kontrollit të menaxhimit; dhe përshkrimet e aktiviteteve të ndryshme që i nënshtrohen auditimeve (prokurimet, mbrojtja e pronës shtetërore, udhëtime/dieta, botimet etj.)

Institucioni e përditësoi këtë manual disa herë me vone. Në vitin 1981 u përgatiten Manuali i Raporteve të Auditimit dhe Manuali i Politikës së Përgjithshme. GAO gjithashtu botoi një Manual për punonjësit, i cili përshkruante politikat bazë për zhvillimin dhe shkrimin e raporteve të auditimit. Në vitin 1989, Manuali i Komunikimit zëvendësoi Manualin e Raporteve të Auditimit. Manuali aktual i Politikave dhe Procedurave të Përgjithshme dhe Manuali i Komunikimit janë në dispozicion në intranetin e GAOs.

Krye-Kontrollori i Pergjithshem Lindsay Warren gjatë mandatit të tij pati marrëdhënie të mira me ligjvënësit dhe gjeti mbështetje të konsiderueshme në Kongres në përpjekjet e tij për të transformuar GAO-n.

c. Në vitin 1954, **Joseph Campbell** u emërua Kontrollori i Pergjithshëm. Ai ishte i pari kontabilist në krye të GAOs, që zhvilloi më tej konceptin e auditimit të plotë dhe të zgjeruar të filluar nga Warren. Ai punësoi më shumë kontabilistë dhe u angazhua për të rritur nivelin profesional të stafit të GAOs. Campbell i kushtoi vëmendje të veçantë punës së zyrave rajonale të GAOs dhe themeloi një Departament të Operacioneve Rajonale për të koordinuar aktivitetet e tyre. Nën drejtimin e tij, puna e GAOs reflektoi ndryshimin e nevojave kombëtare, duke u përfshirë në çështje si menaxhimi financiar i programeve të asistencës së jashtme dhe ushtarake, prokurimin dhe përdorimin e pajisjeve të automatizuara të përpunimit të të dhënave, si dhe projektet e NASA-s. Në vitin 1963, një artikull gazete vinte në dukje se "shakaja e momentit në Uashington është se Sekretari i Mbrojtjes, Robert McNamara ka më shumë frikë nga Joe Campbell se sa nga Nikita Hrushovi."

Në vitin 1966, Presidenti Lyndon B. Johnson emëroi Elmer B. Staats si Krye-Kontrollor të Pergjithshëm të GAO-s. Staats punoi për të përmirësuar përgjegjshmërinë e qeverisë. Ai revitalizoi punën në

Programin e Përmirësimit të Menaxhimit të Përbashkët Financiar. GAO mori një rol udhëheqës në dhënien e udhëzimeve të auditimit. Gjatë viteve 1960, disa shtete modernizuan programet e tyre të auditimit duke përfshirë auditimin e performancës, përveç auditimeve tradicionale financiare. Disa kërkuan udhëzime nga GAO lidhur me zgjerimin e funksioneve të tyre të auditimit. Kongresi dhe Shtëpia e Bardhë po kështu kërkonin rrugë për të forcuar kontrollin mbi grantet federale. Në vitin 1970, Zyra e Buxhetit dhe GAO ranë dakord për formimin e Task Force për Standardet e Auditimit, e cila ndërmori një proces të gjatë kërkimor. Si rezultat i punës, Kontrollori i Përgjithshëm publikoi në vitin 1972 edicionin e parë të Standardeve të Auditimit të Qeverisë, Organizatave, Programeve, Aktiviteteve dhe Funksioneve, i cili u quajt "Libri i verdhë". Në vitet e mëvonshme, GAO i dha librit një titull më konciz, **Standardet e Auditimit të Qeverisë** dhe e përditësoi atë me udhëzime në mënyrë periodike.

Stafi i GAOs, kryesisht kontabilistë, filloi të ndryshojë për tu përshtatur me detyrat e reja të agjencisë. Në vitin 1970, GAO filloi rekrutimin e fizikantëve, shkencëtarëve socialë, profesionistëve të IT, si dhe ekspertë në fusha të tilla si kujdesi shëndetësor, politikat publike dhe menaxhimi i informacionit. Në vitin 1980, shumica e audituesve të agjencisë dhe analistët e menaxhimit tashme ishin ri-klasifikuar si vlerësues, të cilët pasqyronin punën e larmishme në GAO.

Gjatë drejtimit të Staats, GAO investoi në teknologji të reja dhe punësoi individë me grada të ndryshme akademike. Në vitet 1970 dhe 1980, agjencia përdorte gjithnjë e më shumë kompjutera në auditime dhe në operacionet administrative.

d. Në vitin 1981, Presidenti Ronald Reagan emëroi **Charles A. Bowsher** si Krye-Kontrollor të Përgjithshëm i GAO-s. Bowsher punoi për të përmirësuar menaxhimin financiar federal. Ai gjithashtu mbikqyri modernizimin e selisë së GAOs dhe pajisjeve në përdorim të stafit. Ai u përqendrua në ofrimin e informacioneve të dobishme dhe në kohë për Kongresin, falë planifikimit strategjik, kontrollit të proceseve të punës dhe kontrollit të cilësisë ex post të raporteve të auditimit. Kur Bowsher u largua nga detyra në vitin 1996, kërkesat e Kongresit, nga 40% të punës së GAOs në vitin 1981, përbenin mbi 70% të punës së GAO-s. GAO filloi të kryente për herë të parë rishikime tërësore të menaxhimit të përgjithshëm të agjencive qeveritare lidhur me çështje të gjera organizative dhe të menaxhimit të tyre. Zyra gjithashtu filloi publikimin e një serie raportesh me risk të lartë, ku jepeshin informacione mbi aktivitetet e ndjeshme federale si menaxhimi i mbeturinave, mashtrimi, abuzimi dhe keqadministrimi.

e. David M. Walker (1998-2008): GAO si një organizatë model për qeverinë

Nën udhëheqjen e Kontrollorit të Përgjithshëm David M. Walker , GAO u angazhua për të adresuar çështjet me interes të veçantë për Kongresin. Nën drejtimin e tij, GAO zhvilloi një gamë të gjerë auditimesh financiare dhe performance. Këto auditime japin një vështrim profesional dhe objektiv mbi aktivitetet e qeverisë dhe misionet e saj. Ato mbulojnë çdo gjë, nga sfidat e plakjes së popullsisë dhe kërkesat e epokës së informacionit në zhvillim e kërcënimeve të sigurisë kombëtare dhe kompleksitetin e globalizimit. GAO gjithashtu u përkushtua në reformën e qeverisjes së përgjithshme për të ndihmuar agjencitë qeveritare të transformohen në organizata të cilat orientohen drejt rezultateve dhe janë të përgjegjshme ndaj publikut.

Vlerat thelbësore të përgjegjshmërinë/llogaridhëniës, integritetit dhe besueshmërisë, pasqyrojnë përkushtimin e GAOs për një qeverisje më të mirë. Nëpërmjet auditimit të programeve federale, GAO ndihmon në sigurimin se qeveria është përgjegjëse përpara popullit amerikan. Puna e agjencisë reflekton integritet, sepse ajo është profesionale, objektive, e bazuar në fakte, jo-partiake dhe jo ideologjike. GAO përpiqet të japë besueshmëri, duke siguruar informacion të cilësisë së lartë që është në kohë, i saktë, i dobishëm, i qartë dhe i sinqertë.

Nën drejtimin e Walker, GAO punoi për të siguruar në kohë një shërbim cilësor për Kongresin dhe për t'u bërë një organizatë model për qeverinë federale.

GAO organizon procesin e peer review çdo 3 vjet. Ne vitin 2014, ekipi i “Peer Review” per GAO-n me teme *sigurimin e cilesise ne auditim*, i perbere nga auditues nga SAI-t e Norvegjise, Kanadase, Britanise se Madhe, Danimarkes dhe Bahamas-it, theksonte se :

“Ekipi konsideron se GAO ka struktura, marrëveshje, dhe një kulturë që në mënyrë të qartë ka prioritet cilësinë dhe pavarësinë. Institucioni sigurohet që rëndësia e këtyre koncepteve t’i përcillet stafit te ri sapo ai i bashkohet organizatës. Ne u impresionuam nga puna e GAO-s për sigurimin e cilësisë, brenda një kuadri shumë të qartë dhe të plotë, duke e ndihmuar stafin në përmbushjen e standardeve të cilësisë. Mjete te tilla janë të dizenuara për të zvogëluar shkallën, në të cilën cilësia e rezultateve varet nga individet e stafit, si dhe rrisin transparencën e vendimmarrjes”.

GAO dhe INTOSAI

Por GAO, me kalimin e viteve, mori edhe nje permase tjeter cilesore: ate te kontributit dhe vleres se shtuar ne komunitetin INTOSAI te institucioneve supreme te auditimit. Aktualisht, GAO perfaqeson një institucion lider te INTOSAI-t, organizatës botërore të institucioneve supreme të auditimit(SAI-ve), jo vetem për vlerat që mbart, por edhe për kontributin historik që ka dhënë. Rreth 25 vjet më parë, në vitin 1992, Zyra e Auditimit te Qeverise se SHBA (GAO), organizoi Kongresin INCOSAI XIV të INTOSAI-t në Uashington D.C.. Ky eveniment shënoi

zhvillimin më të rëndësishëm në komunitetin e SAI-ve deri në atë kohë, pas Kongresit INCOSAI IX të INTOSAI-t në Lima të Perusë në vitin 1977. Kongresi i Uashingtonit u përqëndrua në Standardet dhe udhëzimet për auditimin suprem publik. Nga Uashingtoni nisi rrugëtimin saga e produktit kryesor të auditimit publik në botë (që më pas tërhoqi edhe vëmendjen e OKB-se dhe sot përbën bazën e monitorimit të Axhendës së saj të Zhvillimit 2030), standardet ISSAI të pranuar ndërkombëtarisht të auditimit suprem. Në kryeqytetin amerikan mori formën e qartë dhe të plotë moto e INTOSAI-t “*Experientia mutua Omnibus prodest(Nga eksperiencia e perbashket fitojne te gjithe)*”.

Me kalimin e viteve, vitaliteti i fituar nga standardet profesionale u ndërthur me përcaktimin e drejtimeve strategjike të INTOSAI-t. GAO mori kryesinë e Grupit të Punës së organizatës për përgatitjen e strategjisë së zhvillimit të auditimit suprem në nivel botëror. Kontributi i GAO-s në këtë Grup ndihmoi edhe strategjinë e zhvillimit 2013-2017 të Kontrollit të Lartë të Shtetit, pasi në themel të saj kjo strategji ka objektivat kryesore të përcaktuara në strategjinë e zhvillimit 2011-2016 të INTOSAI-t, sidomos Objektivi i Dytë i ndërtimit të kapaciteteve institucionale dhe Objektivi i Katërt i zhvillimit drejt një organizate model.

GAO ishte po ashtu në boshtin e përgatitjeve të Planit të ri Strategjik të Zhvillimit 2017-2022 të INTOSAI-t, të miratuar në Kongresin e fundit të organizatës, INCOSAI XXII, zhvilluar në Abu D’habi të Emirateve të

Bashkuara Arabe më datat 5-11 dhjetor 2016. Kryetar i Grupit të Punës për hartimin e Planit Strategjik të INTOSAI-t ishte drejtuesi i GAO-s dhe Krye-Kontrollori i sotem i Përgjithshëm i SHBA-ve, z. **Gene L. Dodaro**, mik i shqiptarëve dhe i KLSH.

Z. Dodaro, në një interviste të tij, dhene Qendres IBM për Biznesin Qeveritar në datën 2 qershor 2016, shprehet “GAO ekziston për të mbështetur Kongresin në kryerjen e përgjegjësisë së tij kushtetuese dhe për të ndihmuar në përmirësimin e performancës dhe përgjegjshmërisë së qeverisë federale, për të mirën e popullit amerikan.. Ne kemi ndihmuar në vlerësimin e programeve dhe aktiviteteve federale për të përcaktuar se sa mirë ato janë duke punuar dhe nëse jo, sesi ato duhet të ndryshohen ose përmirësohen...Ne auditojmë financat e vendit, për të siguruar se paratë e taksapaguesve janë duke u shpenzuar në mënyrë të përshtatshme, në mënyrë eficiente dhe efektive, në përputhje me ligjin federal. Bëjmë auditime të ndryshme financiare të subjekteve qeveritare, duke përfshirë pasqyrat financiare të të gjithë qeverisë federale. Ne ndihmojmë në krijimin e standardeve të kontabilitetit, auditimit dhe kontrollit të menaxhimit për sjelljen e zyrtarëve publikë. Ne gjithashtu prodhojmë një seri raportesh të riskut të lartë, që përfshin fushat të cilat janë veçanërisht të ndjeshme ndaj mashtrimit financiar, shpërdorimeve dhe keqmenaxhimit në qeverinë federale.

Po ashtu, në leksionin e tij në Konferencën Vjetore 2013 të Shoqatës Amerikane të Administratës Publike “Elliot Richardson”, z. Dodaro e

ndan kontributin e organizatës që drejton në katër shtylla. Së pari, ai thekson se etika dhe integriteti formojnë bazën për auditimin. Së dyti, nënvizon rëndësinë që GAO i kushton etikës dhe integritetit në punën e saj. Së treti, nxjerr në pah rolin e organizatës për të zbuluar dhe deklaruar hapur në publik të vërtetat e vështira në qeverisjen publike. Dhe së katërti, ndihmën që institucioni i tij jep në promovimin e etikës dhe integritetit në auditimin publik në të gjithë botën. Në këtë leksion, Dodaro shprehet se *“Si dikush që e ka kaluar karrierën e tij si një auditues federal, mund të them pa hezitim: puna solide audituese, e bazuar në integritetin dhe parimet e tjera etike është e domosdoshme për një mbikqyrje efektive të qeverisë dhe mbajtjen e njerëzve përgjegjës. Puna e GAO-s nxjerr në dritë mangësitë qeveritare, inkurajon sjelljen e duhur nga ana e zyrtarëve publikë dhe e kontraktorëve privatë, si dhe ndihmon për të penguar sjelljen e diskutueshme. Puna solide audituese gjithashtu kontribon në rezultate më të mira të politikave publike dhe në përmirësimin e performancës së qeverisë... Besueshmëria e GAO-s varet nga perceptimi - dhe realiteti - se puna jonë është kryer me integritet dhe sipas parimeve etike...Pa besueshmërinë, një auditim nuk ka shumë vlerë”*.

GAO nuk është thjesht komuniteti i mbi 2900 punonjësve me integritet, përgatitje të lartë profesionale dhe të mirëtrajnuar. Institucioni nxjerr çdo vit me qindra raporte auditimi dhe dëshmi, për t'i siguruar Kongresit dhe drejtuesve të agjencive të pavarura informacion të saktë mbi aktivitetet e

qeverisë. Raportet e tij për Risqet e Larta dhe për mbivendosjet, dublimet apo fragmentimin e punës së qeverisë federale janë shembull për cilindo institucion auditimi në botë. Institucioni jep kontributin e tij si lider në auditim, nëpërmjet standardeve që zbaton, të bazuara mbi rregullat e etikës dhe integritetit, ku janë reflektuar praktikat më të mira të marra nga standardet ISSAI.

Institucioni funksionon tërësisht si një agjenci e pavarur nga Qeveria. Edhe pse GAO nuk ka tagër të detyrojë Qeverinë që të zbatojë përfundimet dhe rekomandimet e auditimeve të saj, institucioni imponohet me vlerat e tij, duke i bindur veprimtarët e tjerë për të vepruar. Pjesëmarrja në seancat e Komisioneve të Kongresit Amerikan është një element veçanërisht i vlefshëm bindës dhe stafi i GAO-s lë çdo detyrë tjetër për ta kryer këtë. Por jo vetëm kaq. Pothuajse të gjitha raportet e auditimit janë dokumente publike dhe vihen në dispozicion për mediat. Vëmendja e mediave ndaj një raporti auditimi mund të jetë një nxitje e fuqishme për veprim korigjues në Qeveri, kështu që GAO bashkëpunon me përfaqësues të mediave të ndryshme. GAO vetë nuk mban konferenca për shtyp, por merr pjesë, nëse i kërkohet, në konferencat për shtyp të mbajtura nga një organ tjetër (mund të jetë dhe një anëtar i Kongresit), i cili e ka kërkuar raportin e auditimit. Në këto konferenca, stafi GAO-s i përgjigjet pyetjeve nga gazetarët.

GAO përbën një model për të gjitha institucionet supreme të auditimit në botë, për pavarësinë, profesionalizmin, transparencën dhe integritetin, vlera këto të përmbajtura në standardet ISSAI të INTOSAI-t.

GAO punon shumë ngushtë me Kongresin Amerikan. Lidhjet janë të shumta dhe të gjera, sidomos ato me disa Komisione të përhershme të Kongresit dhe Senatit. Në rrethana të tjera, lidhje të tilla të ngushta midis një SAI dhe Parlamentit mund të jenë një kërcënim për pavarësinë e SAI-t. Mirëpo ka disa arsye pse GAO ka qenë në gjendje që të ruajë pavarësinë e saj në këtë mjedis. Po përmend dy më kryesoret. Së pari, angazhimi institucional për pavarësinë dhe objektivitetin e institucionit (i përforcuar nga personalitetet në krye të GAO-s që prej krijimit të organizatës në vitin 1921) është themelor për kulturën organizative të SAI-t amerikan. Stafi i tij instinktivisht dhe fuqimisht i reziston çdo përpjekjeje që synon të ushtrojë ndikim të papërshtatshëm në drejtimin apo përmbajtjen e punës së institucionit, madje edhe për rastet kur rrezikohet tjetërsimi i punës nga Senatorë apo Anëtarë me ndikim të fortë të Dhomës së Përfaqësuesve. Së dyti, një mbrojtje dhe garanci akoma më e rëndësishme për pavarësinë e GAO-s qëndron në natyrën e Kongresit Amerikan, në ndarjen e shumtë të pushtetit të tij dhe disiplinën e dobët të brendshme partiake. Karakteristika këto që janë ndoshta të natyrshme në historinë politike dhe në demokracinë amerikane, duke bërë që të ketë shumë pak gjasa që Kongresi të mund të ushtrojë një presion të tillë të qëndrueshëm mbi GAO-n, që të arrijë të

kërcënojnë seriozisht pavarësinë e saj. Për më tepër, ka një bindje të fortë në Kongres - së paku në mesin e shumë nga anëtarët e tij më me ndikim - që kredibiliteti publik i mirëkrijuar i GAO-s është shumë i vlefshëm dhe një aset i Kongresit, si institucion, dhe se Kongresi e ka të pamundur të lejojë që ky kredibilitet të zvogëlohet nga pakënaqësi politike afatshkurtra ose implikime politike të ndonjë auditimi të veçantë ose një serie auditimesh.

Qendra e Ekselencës në Auditim e GAO-s, që Ju zj. St. Laurent drejtoni, është një strukturë qendrore e GAO-s, që punon me të gjitha institucionet e auditimit dhe llogaridhënies qeveritare në botë, për të përmirësuar dhe shtuar, nëpërmjet trajnimeve të saj, kapacitetet e tyre në auditim. Qendra ndihmon institucionet supreme të auditimit publik (SAI-t) të zhvillojnë dhe zbatojnë korniza të shëndosha të sigurimit të cilësisë në auditim dhe plane strategjike e strategji të zhvillimit të burimeve të tyre njerëzore, duke rritur njohuritë për standardet ndërkombëtare të INTOSAI-t.

Mbështetur në këto tradita dhe vlera të patjetërsueshme të kontributit të një SAI si GAO në mbajtjen të përgjegjeshme të administratës së shtetit më të fuqishëm dhe demokratik në botë, por dhe në zhvillimin e auditimit suprem publik, ne si KLSH përkthyem në shqip dhe botuam në vitin 2015 standardet e auditimit të GAO-s, «Yellow Book(Libri i Verdhë)». Leximi dhe përvetësimi i këtyre standardeve nga audituesit e

KLSH-së po i ndihmon ata në punën e tyre të përditshme për të realizuar auditime cilësore.

Në këto vitet e fundit, marrëdhënia jonë si KLSH me GAO-n po forcohet dhe po merr trajta konkrete bashkëpunimi. I jemi mirënjohës GAO-s dhe në veçanti z. Dodaro, drejtuesit të saj, që në harkun kohor të dy viteve 2016-2017 mundësuan dhe po realizojnë trajnimin e tre audituesve tanë për 4 muaj pranë zyrave të GAO-s në Uashington D.C. Kjo eksperiencë që po merret është e një vlere të jashtëzakonshme për ne.

Më datën 30 janar 2017, kur Ju takova në Uashington D.C., se bashku me z. James-Christian Blockwood, Drejtor i Planifikimit Strategjik ne GAO, në vijim të çështjeve të diskutuara në takimin e punës që pata me Krye-Kontrollorin e SHBA-ve z. Dodaro në Abu D’habi në dhjetor 2016, ne biseduam për fushat e bashkëpunimit me Ju si Qender e Ekselencës në trajnime afatgjata e afatshkurtra të audituesve shqiptarë, veçanërisht për Auditimin e Performancës, të IT, në fushën e etikës dhe integritetit në auditim, si dhe në procesin e Planifikimit Strategjik 2018-2022. Jemi gati të presim auditues të GAO-s në Shqipëri për trajnime në fushat e mësipërme. Sfida jonë është të implementojmë standardet e GAO-s, pra të përgatisim “The Albanian Yellow Book”, standardet e auditimit suprem publik të Shqipërisë.

Per keto bashkëpunime dhe per shume fusha te tjera te shkëmbimit te eksperiences mes dy SAI-ve tona, jemi gati te nenshkruajme nje marrëveshje me Ju si Qender, e cila do te mundësonte dergimin e nje grupi audituesish te KLSH per trajnim prane Qendres se Ekselences ne Uashington D.C., ç'ka do te perbente nje investim thelbësor në të ardhmen e kualifikimit profesional te audituesve tane.